



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr. 60/01-38147/21
Kaçanik, 29.12.2021

Në bazë të Vendimit të KQZ-së, Nr. 3472-2021 të datës 17.12.2021, më të cilin është caktuar zëvendësimi i anëtares së dorëhequr, Hafize Sallahi, me kandidaten e radhës nga po i njëjti subjekt politik AAK, Rabije Sallahi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Dhjetor 2021 i konstatoj:

**Ndryshim Plotësimin e përbërjes së Kuvendit të Komunës Kaçanik
të legjislaturës së gjashtë (7) të zgjedhur me 17 tetor 2021**

- 1. RABIJE SALLAHI** – nga subjekti politik “Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK” sipas Vendimit të KQZ Nr.3472-2021 i datës 17.12.2021, (bashkangjitur kësaj shkrese) është emëruar anëtare (këshilltare) e Kuvendit të Komunës Kaçanik, në vend të anëtares së dorëhequr, Hafize Sallahi.
2. Betimin për anëtar të kuvendit të komunës, Rabije Sallahi e ka dhënë në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës me 29 dhjetor 2021, nga kjo datë realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të kuvendit të komunës, përfshirë edhe kompensimin (paushallin dhe kompensimin për pjesëmarrje në mbledhje).
3. Anëtarja e kuvendit të komunës Kaçanik nga pika 1 e kësaj shkrese, më rastin e dhënies së betimit solemn dhe nënshkrimit të deklaratës solemne, para kuvendit të komunës, u zotua se merr përsipër detyrat e anëtarit të kuvendit komunal të përcaktuara si në dispozitat e nenit 35.4 të LVL.
4. Mandati i anëtarit të kuvendit të komunës është i lidhur më mandatin e kuvendit të komunës, fillon nga data e emërimit në këtë post- respektivisht pas dhënies së betimit solemn dhe nënshkrimit të deklaratës solemne për anëtar të kuvendit të komunës Kaçanik, ndërsa përfundon sipas dispozitave të nenit 37.2 të LVL.
5. Obligohen organet relevante të komunës t’i marrin veprimet e nevojshme për futjen në listën e pagave anëtares e kuvendit të komunës, Rabije Sallahi dhe heqjen nga lista e pagave Hafize Sallahi.

Me këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës- Njësia e Personelit, Drejtorja e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Data 20.12.2021 Vendi KAÇANIK
Nj. org. Numri Shtojcë



01 60/01-3847

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

7-12-2021



Prishtinë / Priština

Nr./Br. 3472-2021

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), nenin 65.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 17.12.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Rabije Sallahi**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Hafize Sallahi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Rabije Sallahi, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 15.12.2021, Nr.3415/2021, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj.Hafize Sallahi, me rastin e dorëheqjes së saj, për arsye të marrjes së pozitës ekzekutive.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidatja në listën e rirenditur është znj.Rabije Sallahi.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 17.12.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

